



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 16/09/2022 Ref: 1319/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), vendimin nr.Ref.:875/16 datë 22.09.2016, vendimin e KShC-së 467/18D datë 18.05.2018, vendimin e MASHTI 01/B nr.1701 datë 08.07.2022 dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 104-të, të mbajtur më 01.09.2022, mori:

### V E N D I M

- I. Aprovohet** kërkesa e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, për zgjatjen e periudhës së akreditimit edhe për një (1) vit akademik (nga 1 tetor 2022 - 30 shtator 2023) për programet e studimeve:
  1. Programi Fillor, BA, 240 ECTS, (Gjuhë Turke dhe Gjuhë Boshnjake);
  2. Programi Parafillor, BA, 240 ECTS, (Gjuhë Turke dhe Gjuhë Boshnjake);
  3. Teknologji Informative dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS, (Gjuhë Turke dhe Gjuhë Boshnjake),
- II.** Numri i studentëve, në mungesë të përcaktimit me vendim të KShC-së, është përcaktuar me vendimin e MASHTI 01/B nr.1701, datë 08.07.2022 dhe aplikohet vetëm për periudhën 1 tetor 2022 - 30 shtator 2023.
- III.** Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV.** Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren që çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- V.** AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI.** Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për zgjatje të afatit të akreditimit për programet e studimit;

1. Programi Fillor, BA, 240 ECTS, (Gjuhë Turke dhe Gjuhë Boshnjake);
2. Programi Parafillor, BA, 240 ECTS, (Gjuhë Turke dhe Gjuhë Boshnjake);
3. Teknologji Informative dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS, (Gjuhë Turke dhe Gjuhë Boshnjake),

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 104-të, të mbajtur më 01.09.2022, ka shqyrtuar kërkesën e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe duke u bazuar në arsyeshmërinë e kërkesës, opinionin ligjor të MASHTI Nr.prot:324 datë 18.02.2022 dhe në mbështetje të nenit 26, nën nënparagrafit 5.3.10 të Udhëzimit Administrativ (MASHT)Nr.15/2018, citojmë: "*Programet e studimit në gjuhët e komuniteteve (boshnjake dhe turke) në universitetet publike të Republikës së Kosovës të ofruara deri më tani, të cilat kanë mundësi të stafit akademik me gradën Dr.Sc, ashtu siç është përcaktuar me këtë UA, do të lejohen të ofrohen paralelisht me programet e akredituara në gjuhën shqipe, me kusht që brenda periudhës kalimtare prej pesë (5) vitesh, këto institucione të ngrisin kapacitetet vetanake të cilat sigurojnë qëndrueshmërinë e ofrimit të programit të studimit, sipas kërkesave të mësipërme të këtij UA. Të gjitha kërkesat tjera të vlerësimit të përcaktuara për akreditimin e programeve zbatohen sipas kërkesave të këtij UA", vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Ass. Dr. Hasnija Hazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

